



Instituti i Kërkimeve Urbane

STUDIM KRAHASUES - “MENAXHIMI I BUXHETIT DHE KAPACITETI FISKAL”, KOMUNAT NGA RAJONI I KORÇËS.

Ky studim është pjesë e një projekti për analizën e buxhetit dhe menaxhimin financiar që është financiar dhe zbatuar nga organizata suedeze: SIDA dhe SIPU International për 9 komunat pilote në Rajonin e Korçës. Komunat e përfshira në këtë projekt ishin: Progër, Qender-Bilisht, Bulgarec, Voskop, Voskopoje, Mollas, Liqenas, Hudenisht, dhe Proptisht.

Ky projekt ka ofruar asistencë teknike në tre komponentë të ndryshëm:

1. Asistenca teknike në përdorimin e teknikave të reja dhe mënyra të reja mbi sistemin buxhetor, për të llogaritur mbledhjen e taksave;
2. Asistenca teknike në përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit vendor për vitin 2005, si dhe për periudhën afatmesme 2005-2007;
3. Mbështetje për forcimin e procesit demokratik lidhur me menaxhimin e financave lokale;

Ky studim është pjesë e komponentit të dytë të këtij projekti dhe kjo është e lidhur me "Përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit vendor për vitin 2005, dhe për periudhën afatmesme 2005-2007". Gjithsesi, në këtë studim janë përfshirë elemente të tjera që kanë të bëjnë me financat lokale, menaxhimin dhe monitorimin.

Përmbajtja dhe struktura e projektit

Ky studim përfshin pesë kapituj si dhe disa tabela në anekse:

Kapitulli I: Analiza e zhvillimit të të ardhurave të komunave në rajonin e Korçës.

Analiza për komunat pilote fillon me një analizë e shkuar e burimit të të ardhurave për vitet 2002-2004 si dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në përmasat e tyre.

Kapitulli II: Analiza e zhvillimit të shpenzimeve të komunave

Analiza e buxhetit për komunat në rajonin e Korçës për vitin 2002 - 2004 është përqendruar në tre tema kryesore: analiza e shpenzimeve dinamike dhe të ndërlidhjes midis shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime kapitale; shpenzimet e analizuar sipas funksioneve të ndryshme dhe aktiviteteve që NjQV të ndryshme zbatojnë dhe sipas burimeve të tyre financiare; dhe analiza e shpenzimeve operative sipas zërave dhe kategorive kryesore;

Kapitulli III: Parashikim i detajuar për të ardhurat vendore për vitet 2005 dhe 2005-2007

Në këtë seksion, ne jemi përqendruar në planifikimin e detajuar dhe analitik të të ardhurave buxhetore në bazë të autoritetit që ligji dhe procedurat administrative i jepin NjQV për taksat dhe tarifatat vendore të sistemit.

Për shkak të nevojës për të analizuar dhe parashikuar të ardhurat të tyre sipas paraqitjes tabelare për buxhetin, janë përdorur disa forma dhe tabela që ndihmojnë në llogaritjen e detajuar të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore; të ardhurat nga bizneset e vogla; si dhe të ardhurat nga toka bujqësore dhe kapacitetin e tyre fiskal.

Bazuar në të dhënat e mbledhura, disa tregues kryesorë janë llogaritur duke përdorur burime të veta të të ardhurave, dhe këto shërbejnë për krahasime dhe identifikimin e praktikave më të mira ndërmjet komunave të ndryshme, të tilla si: pesha fiskale apo kontributi për banor nga pagesa e taksave dhe tarifave vendore; pesha fiskale apo kontributi për biznesin e vogël; dhe pesha fiskale apo kontributi për familje nga toka bujqësore;

Kapitulli IV: Metoda të avancuara për parashikimin dhe monitorimin e shpenzimeve vendore për vitet 2005 dhe 2005-2007

Duke marrë në konsideratë buxhetin e thjeshtë të të ardhurave për komunat në rajonin e Korçës, si dhe strukturën e ngushtë të shpenzimeve, në këtë kapitull diskutohet mbi planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve përmes teknikave të avancuara. Në këtë metodë të re, NjQV jo vetëm parashikojnë dhe kontrollojnë shpenzimet sipas zërave dhe kategorive por gjithashtu ata planifikojnë dhe monitorojnë këto shpenzime sipas funksioneve dhe shërbimeve që këto komuna ofrojnë si dhe ofrojnë menaxhimin e performancës për disa nga këto shërbime.

Kapitulli V: Buxheti i pavarur i investimeve kapitale

Ky kapitull përshkruan buxhetimin për investimet kapitale, psh. për ato projekte të cilat do të financohen tërësisht nga të ardhurat e veta. Për këtë arsye, në këtë kapitull diskutohet metoda e llogaritjes për fondet e pakushtëzuara për investime në vitin e planifikuar dhe në afat-mesëm, 3 vite. Ekzistojnë disa kritere përzgjedhëse për projektet për investim me prioritet, si dhe gjithashtu ekzistojnë teknika për balancimin e nevojave për investime me fonde të pakushtëzuara.